- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik***, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____



Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit _____

Nënshkrimi _____

Vula _____



Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohej në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe

kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:


Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi _____

Vula _____



Shtojca 8

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

(Te detyrueshme për tu plotësuar për të gjitha Lotet që operatori ekonomik do të konkurojë/ofertoje)

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë **(për të gjitha lotet)** :

- a. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

- c. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 QKL license per artitujt me origjine shtazore. Kodi II.1 A (e detyrueshme per tu plotesuar per lotin e dyte, trete, katert, peste)

2.1.1.b QKL license per per furre dhe prodhim buke(loti 1.Buke)

2.1.2 Leje higjeno – sanitare(e detyrueshme per te gjithë lotet)

2.1.3 Libreze Shendetesore per te gjithë punonjesit e subjektit pjesmarres ne kete procedure prokurimi, (e detyrueshme per tu plotesuar per te gjitha lotet)

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar :

(per te gjithë lotet)

2.2.1Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit për Lotin ku operatori merr pjese.

2.2.2Kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: 2015, 2016, 2017, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit të **Lotit** ne te cilin OE konkuron . Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë :

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes,
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara . **Per te gjithë lotet**

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te kete nje numer mesatar prej 3 (tre) punonjesish ne muaj për , të siguruar për periudhën dhjetor 2018 – Janar 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën Dhjetor 2018 – Janar 2019

- Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën dhjetor 2018 - Janar 2019.

Per te gjithë lotet

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te kete Mjet transporti ATP, ne pronesi ose ne përdorim, sipas kontrates noteriale, te vertetuar me leje qarkullimi, siguracionet, taksat e mjetit, kontrolli i mjetit, leje higjeno-sanitare , si dhe certificate pronesie(**Per lotin 1. Buke , per lotin 5.Kolonjale**).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi, huapërdorje ose me qira, për të cilin të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë (**Per lotin 2,Mish vici, lotin 3.Bylmet dhe lotin 4.Fruta perime**) :

- a) Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj;
ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ **Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:**

- Kontratë huaje.

➤ **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**

- Kontratë qiraje.

- b) leje qarkullimi,

- c) certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

- d) policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

- e) akt miratimi higjeno – sanitar.

- **2.3.4** Operatori Ekonomik, kete ne pronesi ose me kontrate qeraje ose kontrate sherbimi furre buke, e cila duhet te jete e pajisur me leje higjeno sanitare, leje mjedisore dhe QKB. (**per lotin 1.Buke**) :

- **Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL)**

- **Leje Higjeno-Sanitare.**

- **Certifikata dezinfektimi per ambientin “Furre Buke”, te vlefshme.**

2.3.5 Te kete pike thertore ne pronesi ose kontrate qeraje ose kontrate sherbimi. Operatori qe disponon thertoren duhet te kete (**Per lotin 2.Mish vici**) :

- *Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL)*

- *Leje Higjeno-Sanitare.*

- *Leje Mjedisore*

- **Certifikata dezinfektimi per ambientin “Thertore”, te vlefshme.**

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te kete “Njesi Prodhimi ose Tregetimi Bulmeti”, ne

pronesi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale. Operatori qe disponon njesi prodhimi/tregetimi bulmeti duhet te kete (**Per Loti 3.Bylmet**) :

- *Leje Higjeno-Sanitare*
- *Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL)*
- *Certifikata dezinfektimi per ambientin “Njesi Prodhimi ose Tregetimi Bulmeti”, te vlefshme.*

2.3.7 Duke patur parasysh natyren e ketij sherbimi operatori ekonomik me seli të ushtrimit të aktivitetit jashtë qytetit të Kukësit , duhet të ketë minimumi nje filial brenda territorit administrativ te Bashkise Kukes , te pershtatshem per ushtrimin e aktivitetit per lotin te cilin konkurron (per kete filial duhet te paraqese dokumenta ligjore si : Kontrate qeraje ose kontratë shërbimi , Certificate e pronesise se objektit , Certificate dezinfektimi per ambientin , Leje Higjeno-Sanitare) **Per te gjitha lotet.**

2.3.8 Operatori ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin te paraqese dokumentacionin provues, ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.



Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Loti I – Bukë masive R 70

Buka e grurit do të prodhohet me miell rreze 70 %, i stazhionuar për një periudhë prej 10-30 ditësh. Mielli duhet të jetë i freskët, me ngjyrë, erë, shije dhe lageshtirë konforme standarteve perkatese të miellit me rreze 70 %. Mielli nuk duhet të ketë asnjë lloj lende të huaj. Buka duhet të ketë forme të drejta dhe normale, pa deformime dhe sipërfaqja e bukes duhet të jetë e lemuar dhe pa plasje të ndryshme. Vellimi i bukes duhet të jetë i mjeftueshëm. Shija, era, lageshtira dhe aciditeti i bukes duhet të jetë konforme standartit teknik të prodhimit të saj. Korja e bukes – duhet të jetë e lemuar, pa djegie, pa shkeputje të saj nga tuli, ngjyra e njellojtë, mjalti në të kuqerremte, në të gjithë sipërfaqen. Tuli duhet të jetë i pjekur mirë, me porozitet të imët në të gjithë vëllimin e tij dhe nuk duhet të ketë gjurmë mielli të pabrumosura. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me erë të huaj, me shije të hidhur e të thartë, me lende të huaja, me lageshtirë jo normale, me shije myku. Treguesit fiziko – kimik: Buka preferohet në formë katerkendeshe dhe me peshë 1(një) kg, lageshtira jo me shumë se 44.5 %, poroziteti jo me pak se 72%, aciditeti jo me shumë se 45%. Furnizimi i bukes do të bëhet çdo ditë pranë magazinave të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Kukes sipas kërkesës. Amballazhi i transportimit të bukes duhet të jetë i pastër dhe të sigurojë mos demtimin e saj. Mjetet transportuese duhet të jenë të pastra, të mbyllura që të sigurohet transportim normal i bukes deri në destinacionin perkates.

Loti 2- Mish viçi

Bazuar në STASH 1441/87, Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Aktin Normativ nr.4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për thyerjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.

Lloji: Mish viçi i freskët, cilësia e parë.

Treguesit shqisorë:

Pamja e jashtme: Mish i butë me ngjyrë tendafil i çelët. Sipërfaqja e mishit e mbuluar me cipë të hollë tharje, në prerje duket e ndritshme jo e ngjithshme, me ngjyrë rozë karakteristike, të ketë pak dhjamë të bardhë nën lëkurë dhe diçka më tepër në brendësi. Forma e trupit të jetë e rrumbullakosur. Duhet të jetë karkasë e plotë, ose e ndarë në 4 pjesë, cilesi e parë.

Ngjyra: Mishi i viçit ka ngjyrë rozë, e ndryshme nga lopa që ka ngjyrë të kuqe, dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme, ngjyra e dhjamt është e bardhë tek kafshet e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.

Era: e këndshme, karakteristike e llojit.

Palca e kockave: Mbush plotësisht kanalën e palcës së kockave. Ngjyra është rozë e verdhë.

Lëngu i mishit pas zierjes: i tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.

Kërkesa cilësore: Gjatë thyerjes, mishi i viçit trajtohet në gjysmë trupi e në çerek. Trupi ndahet në mes të vertebrave kur ndahet në gjysmë, ndërsa ndarja në çerek bëhet ndërmjet brinjës 12 e 13. Koka veçohet nga trupi në vertebrën e parë, këmbët tek kupa e gjurit.

Konsistenca: E butë dhe elastike, gjurma që formohet kur mishi shtypet me gisht zhduket shpejt. Në prerje duket kompakt, lëngu del me vështirësi dhe është i tejdukshëm.

Karakteristika e mishit të freskët nuk duhet të ketë erë të huaj dhe nuanca jeshile në sipërfaqe.

Furnizimi me mish viçi të jetë në sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor pa të brendshme dhe kokë.

Tregëtimi i mishit të freskët bëhet jo më parë se 6 orë nga koha e thyerjes në verë, ndërsa në dimër 12 orë.

Mishi të jetë i cilesisë së parë, i shoqëruar me raport veterinar sipas ligjeve në fuqi. Viçi duhet të jetë deri 1 (një) vjeç dhe me peshë deri 100 kg.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Të mos ketë përqindje të madhe dhjami ,preferohet kofshë e pasme.

Transporti të bëhet me mjetet e firmës të tipit frigoriferik të specifikuar dhe të përshtatshme për ruajtjen e mishit gjatë transportit.

Ruajtja ne frigorifer në temperaturën nga 0° - 4° Celsius.

Mishi detyrimisht duhet të jetë i kontrolluar dhe i vulosur nga veterineri në çdo pjesë.

Afati i garancisë: 12 orë nga koha e marrjes në dorëzim dhe përdorim.

Mishi i freskët shoqërohet me dokument veterinar ditor (raport veterinar).

Mishi duhet te theret ne ambiente (thertore të licensuara), të cilat plotësojnë standartet higjeno – sanitare dhe veterinare.

Ambalazhimi me qese sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor duhet të ketë vulën e kontrollit veterinar në prerjet me peshë më të madhe.

Qeset e ambalazhit duhet të plotësojnë standardet e kërkuara për ambalazhimin e produkteve të mishit, të jenë qese të pa-riciklueshme dhe të shoqëruara me çertifikatë cilësie.

Mishi duhet të shoqërohet çdo ditë, me raport veterinar.

Vula dhe të dhënat e personave përgjegjës që plotësojnë raportin duhet të jenë të lexueshme mirë.

Raporti veterinar duhet të paraqitet në original ose fotokopje të noterizuar.

Loti 3.Bylmet (Qumesht , Kos , Djathe , Gjalp , Veze)

1. QUMËSHT TETRAPAK

Bazuar ne STASH 1563/87, Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, PER ZEVENDESIMIN E ANEKSIT I, TE URDHURIT NR.234, DT. 20.05.2014 PER MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KRITERET MIKROBIOLOGJIKE PER PRODUKTET USHQIMORE”

Kërkesat cilësore :

Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.

Gjate përpunimit dhe tregtimit te zbatohen rregullat higjeno sanitare e veterinare ne fuqi.

Nuk duhet të lejohet përdorimi i lendeve konservuese, neutralizuese dhe te huaja.

Te plotësoje treguesit organo-leptike dhe ato fiziko-kimike.

Pamja e jashtme: Te jete leng homogjen, pa lende të huaja qe notojne apo precipitojnë me rrjedhje të njëllajtë dhe pa ndërprerje.

Ngjyra e bardhe e njëllajto, nuance e lehte e verdhë .

Shija dhe era te kendeshme, lehtesisht e ëmbël, shije e lehte zierjeje, pa shije ose ere te huaj.

Qumeshti duhet të jete i ambalazhuar ne kuti tetrapak ne peshe 1Lit dhe i shoqeruar me Raport Analizë “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analizë Mikrobilogjike” nga institucione ligjorë.

Treguesit fiziko-kimikë:

1. Dendësia në 20 gradë celcius jo më pak se 1.028 – 1.029 gr/litër.

2. Pika e ngrirjes jo më e lartë se –0,520 gradë C

3. Përmbajtja e yndyrës në %, 3-3.4 %.

4. Aciditeti ne grade Tjorner:

Në periudhën 01 Tetor – 31 Mars jo me I lartë se se 19

Në periudhën 01 Prill – 30 Shtator jo me I lartë se se 20

5. Përmbajtja e lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se 8.5 %

Dokumentat Standarde të Tenderit

6. Prova e pasterizimit (e fosfatazes dhe peroksidezes) duhet negative.

Pastertia pa mbetje me site mendafshi apo merle pambuku dyfishe.

Ambalazhimi brenda kushteve higjeno-sanitare ,me peshe 1 lit ku te jene vendosur:

Marketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit .

Data e skadimit.

Përqindja e yndyrës.

Temperatura e ruajtjes së produktit.

Analiza mikrobiologjike

1. Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rruajtja e transportimi ne temperature 2 deri ne 8 grade.

Ngarkesa mikrobike sipas normave te percaktuara nga Ministria e Shendetesise.

Malli duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

2. KOS

STASH 1443-87

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, PER ZEVENDESIMIN E ANEKSIT I, TE URDHRIT NR.234, DT. 20.05.2014 PER MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KRITERET MIKROBIOLOGJIKE PER PRODUKTET USHQIMORE

Kërkesat cilësore

Të plotesoje treguesit e cilesise si me poshtë:

- Ngjyra: e bardhe, në sipërfaqe e bardhe lehtësisht në krem.
- Struktura: e ngjeshur, pa pore, ne prerje pa shtresa dhe ndarje hirre.
- Era dhe shija: e kendeshme, karakteristike e kosit te embel, lehtësisht e tharte

Treguesit fiziko-kimikë:

- Aciditi ne grade
TJORNER jo më shume se 120
Yndyra në % 2 ± 0.1
- Ngarkesa mikrobiale sipas normavete miratuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi,marketimi dhe etiketimi

Kosi ambalazhohet ne paketim tetrapack, shishe qelqi ose plastike, me grykë të gjerë, me mase 500g - 1 kg te mbyllur me kapak.

Ambalazhet qe perdoren te jene ne gjendje te mire,te paster,te thata dhe pa ere te huaj.

Meteriali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjenosanitare nga standardet përkatëse.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Shmangiet e lejuara ndaj vëllimit nominal të kosit të ambalazhuar janë:

- ± 20 g per ambalazhet 1000 g
- ± 15 g per ambalazhet 500 g

Në çdo paketim vendoset etiketa ku shënohet:

- Emri i ndërmarrjes prodhuese
- Përqindja e yndyrës
- Dita e prodhimit
- Standarti në fuqi

Etiketimi i kosit të ambalazhuar në kuti bëhet me stampim.

Ruajtja dhe transporti:

Kosi ruhet e tregëtohet në frigorifer në temperatura nën 10 gradë C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur. Koha e ruajtjes në frigorifer është 24 orë nga koha e prodhimit.

Transporti bëhet me mjete të, mbuluara, të pastra ose me mjete frigoriferike.

Analize mikrobiologjike

Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

3. DJATH I BARDHE

Bazuar në STASH 1410/87.

Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, PER ZEVENDESIMIN E ANEKSIT I, TE URDHRIT NR.234, DT. 20.05.2014 PER MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KRITERET MIKROBIOLOGJIKE PER PRODUKTET USHQIMORE”

Lloji: Djath fetë cilësia e parë (lope)

Te jetë i stazhionuar jo më pak se 45 ditë, të mos jetë i falsifikuar me niseshte apo lëndë të huaja.

Ngjyra: E bardhë deri në krem

Forma: prizem, trekëndesh me një faqe anësore cilindrike.

Masa e formës në g, 0.5-1-2-3-4 kg.

Pamja e jashtme dhe e brendshme: e formuar mire, e paster dhe pa njolla.

Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe. Në prerje është e njellojte, e paster, pa lëndë të huaja me sythe teknike, me ngjyrë të bardhë deri në krem.

Struktura dhe konsistenca: e lemuar, jo e fortë dhe pa dallim shtresash.

Era dhe shija: E këndshme, specifike e djathit të butë të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse, pa shije e ere të huaj.

Treguesit fiziko kimikë:

1-Lageshtira në %, jo më shumë se:

Per periudhën 1.05- 30.09, %“52”

Per periudhën 1.10.- 30.04, %“56”

2- Lendet e thata në %, jo më pak se

Per periudhën 1.05- 30.09, %“48”

Per periudhën 1.10.- 30.04, %“44”

3- Yndyra në lendet e thata në %, jo më pak se % 30-60

4- Kripë në % deri 4 ± 1 .

5- Ngarkesa mikrobike, brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Dokumentat Standarde të Tenderit

6- Në çdo parti djathi lejohen deri ne 5 % copa dhe 2 % therime, masa e nje cope me e madhe ose e barabartë me 50 gr.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Analiza mikrobiologjike (bazuar urdhri 645, dt.23.12.2016)

E-coli 100-1000 cfu/ml

Staphylococci 100-1000 cfu/ml

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” dhe “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

Amballazhimi:

Brenda kushteve higjieno - sanitare, i ndarë në pesha te vogla nga 0.5, 1, 2, 3, 4, 5 kg, sipas kërkesave të Entit.

Në rastet kur djathi është i ndarë në pesha të vogla, secila copë duhet të ambalazhohet me material ambalazhues të lejuar dhe të përshtatshëm për këtë produkt.

Mbi çdo ambalazh me djathe vendoset etiketa ne të cilën shenohen:

Marketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit (lloji i djathit)

Cilësia

Masa neto.

Data e prodhimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimor, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre qe të mos shkeputet nga ambalazhi.

Kur djathi është i ambalazhuar në kuti kartoni tretrapack, ne kuti duhet te shenohet: emërtimi i produktit, data e prodhimit, data e skadences dhe treguesit fiziko-kimikë.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zevendesuar , apo plotësuar me nje tjetër, shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me çertifikatë orgjine dhe raportë analize sipas legjislacionit ne fuqi.

Ruajtja dhe transporti:

Rruajtja: Ne frigorifer per 12 muaj ne temperature nga 3 deri ne 5 gradë C, lageshtia relative e ajrit 95 %.

Transporti I djathit bëhet me mjete frigoriferike.

4. GJALP

Gjalpi kerkohet te jete prodhim vendi me baze qumesht lope, delje ose dhie, i fresket. Ngjyra te jete e verdhe karekteristike e gjalpit te lopes ose e bardhe karekteristike gjalpit te dhise dhe deles. Nuk lejohen perberes te tjere, njolla te erreta karekteristike e gjalpit jo te fresket. Shija te jete e kendshme, pa erera te tjera jo natyrale. Ambalazhimi te jete me kuti kartoni ne brendesi te mbeshjtjelle me leter celofoni standarte 10, 20 ose 30 kg. Malli te shoqerohet me certifikate te cilese sipas standarteve te miratuara.

Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit dhe data e skadences.

Furnizimi me djathe dhe gjalpe do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit

deri ne magazinat e bleresit.

5.VEZE PULE

Kërkesat cilësore

- 1- Pamja e jashtme, e pastër dhe pa plasje. Lejohen ndotje të lehta.
 - 2- Dhoma e ajrit (lartesia) mm, jo me shume se 9 mm.
 - 3- E bardha e vezes. E dendur e kulluar dhe e paster pa njolla gjaku (të kontrolluar ne ovoskop).
 - 4- E verdha e vezes. Kompakte e ndodhur ne pozicionin qendror pak e levizshme. Lejohet devijim i vogel nga pozicioni qendror.
 - 5- Era: pa ere prishje dhe ere tjeter të huaj.
 - 6- Masa.ne gr, jo me pak se 50.
 - 7- Ç’do kokërr duhet te jete e vulosur ku te përmbaje markën dhe datën e sakdencës.
 - 8- Gjithashtu duhet qe çdo parti malli te shoqërohet me raport analizë ku kjo e fundit te përputhet me datën dhe markën e vulës.
- “Raport Analiza Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në original, ose fotokopje të noterizuara.

Amballazhimi

- Vezët ambalazhohen ne kartona fole me kapacitet 30 veze secila dhe ne çdo kuti kartoni vendosen 12 cope kartona fole.
- Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shenohen:
Marketimi,Emri i ndërmarrjes prodhuese, Sasia, Data e prodhimit dhe e skadences. ———

Loti 4.Fruta perime



Bazuar ne STASH 1726-88

Lloji. DOMATE PER TREG CILESIA E PARE

KERKESAT CILESORE

-**PAMJA E JASHTME** .Të fresketa, me forme tipike të kultivarit,te plota,të pastra,të pavrara,të pashtypura,pakalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit ,të paprekura nga semundjet dhe demtuesit si dhe të palagura .

-**PJEKURIA DHE NGJYRA** .Me pjekuri normale ,me ngjyre të kuqe ,lehtesisht roze dhe jeshile rreth bishtit.Nuk lejohen domate të tejppjekura ,të zbutura e të vyshkura .

-**DEMTIME E SEMUNDJE**.Nuk lejohen .

-**TË PLASURA E TË VRARA LEHTESISHT** .Per llojet e mesme dhe të vona lejohen deri ne 5% plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje langu (të kalçifikuara).

-**Madhesia e kokrrës (diametri me i madh gjeresor),cm, jo me pak se:**

Per të hershmet .5.

Per të mesmet dhe të vonat . 7.

Per të mesmet e të vonat kumbullore (gjatesia 5).

Ambalazhami dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

Prodhuesi.

Lloji i prodhimit.

Cilesia .

Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik, duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

2.Speci

Kerkohet cilesia e pare, te jene me forme e ngjyre te kultivarit, te fresketa, te pastra dhe me pjekuri natyrale. Lejohen demtime jo me shume se 3 %. Shija te jete karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegese e lehte. Nuk lejohet perzierja e specave djeges me ato jo djeges. Gjatesia te jete per te gjatat mbi 10 cm dhe per te rrumbullaktat mbi 7 cm.

3.Patellxhan

Kerkohet cilesia e pare, te jene te fresket, te paster, me siperfaqje te lemuar, me ngjyre te zeze ne manushaqe, me pjekuri normale, me flete jeshile me nuanca te dobeta manushaqe, te pa vyshkura. Demtime te ndryshme e semundje nuk lejohen. Per te gjatet kerkohet diametri jo me shume se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm. Gjatesia e bishtit te jete jo me shume se 4 cm.

4.Bamja

Kerkohen te jene te fresketa, te shendosha, te pastra, me fije normale per kultivarin dhe fara qe duket lehte, me forme te drejte, lehtesisht te deformuar. Forma te jete e nje prizmi shumekendesh qe ngushtohet ne maje, te pa drunjezuara e pa fije. Gjatesia e cilesise se pare per bamjen frutshkurter te jete deri ne 6 cm dhe per ate frutgjate te jete deri ne 8 cm. Lejohet deri ne 5 % te partise me vyshkje te lehte. Nuk lejohet me semundje e demtues. Ngjyra te jete tipike per kultivarin. Fruti te jete i bute, me fara te vogla ne fazen e qumeshtit. Lejohet me fruta te tejpekura deri ne masen 2% per cilesine e pare.

5.KARROTA

Lloji :Karrota per treg cilesia e pare.

Kerkesat cilesore :

Pamja e jashtme:

Të fresket me ngjyre e forme tipike të kultivarit , me perkulje të lehte .

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

Prodhuesi .

Lloji i prodhimit.

Cilesia .

Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

- Me rrënje te prera.
- Gjatësia te mos jete me shume se 5 cm.
- Te mos ketë prani te barërave te tjera.
- Trupi te jene i plote pa dëmtime nga krimbat, pa dëmtime mekanike, te freskëta dhe te pa vyshkura.

6.QEPE E THATE

Pamja e jashtme: Me pjekuri të plote. Me cipe e bisht të thate, të shendosha e të plota. Me ngjyre e forme tipike të kultivarit dhe me gjatesi të bishtit deri ne 7 cm.

Diametri ne cm (madhesia e kokrrës)

per ovalet 4-8

per llojet e tjera 5-10

Demtime mekanike cifla, bishta, semundje,lejohen jo me shume se 1 % e parties me demtime të lehta dhe 1 % lende të huaja (cifla, bishta). Me semundje nuk lejohen.

Të ngrira ,të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Furnizimi do të kryhet me sasi të standardizuara sipas kërkesës së AK.

Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.Qepa e thate ambalazhohet edhe ne thase.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

Prodhuesi, Lloji i prodhimit, Cilesia.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore të tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

7.QEPE E NJOME

Lloji. Qepe e njome cilësi e pare.

Kërkesat cilësore:

-Pamja e jashtme e freskët, e pastër, e njome, me ngjyre të bardhe në jeshile , e pavyshkur dhe e lare me ujë të pijshëm.

- Diametri ne pjesën me të trashe, cm. Mbi 0.5-1.5 .

- Gjatesia e kercellit ne cm. 15-25 .

- Gjatesia e gjethit nga rozeta ,cm, jo me shume se “10”.

- Sistemi rrenjor në cm, jo me shume se 1.

- Demtime e semundje - nuk lejohen .

Ambalazhami dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Qepërt e njoma do të kërkohen në lidhje sipas kërkesës së AK.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet: Prodhuesi, Lloji i prodhimit, Cilesia. Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskat behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore të tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

8. PRESH

Bazuar ne STASH 1759/88.

Lloji. Presh cilësi e parë

Kërkesat cilësore

-Pamja e jashtme i freskët, i pastër, i njome, me ngjyre të bardhe në jeshile , i pavyshkur dhe i lare me ujë të pijshëm.

- Diametri ne pjesën me të trashe, cm. Mbi 2.5-3.5 .

- Gjatesia e kercellit ne cm.25-45 .

- Gjatesia e gjethit nga rozeta ,cm, jo me shume se “20”.

- Sistemi rrenjor në cm, jo me shume se 1.

- Demtime e semundje.Nuk lejohen .

Ambalazhami dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi. Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet: Prodhuesi, Lloji i prodhimit, Cilesia .Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskat behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore të tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

9. LAKER E BARDHE

Bazuar ne STASH 1758-88.

Lloji LAKER e bardhe

KERKESAT CILESORE.

1.Pamja e jashtme:Të zhvilluara, me mbeshtjellje fletesh, e forte ne prekje.Lejohen lakra të pangjeshura deri 5% të parties.

Dokumentat Standarde të Tenderit

2.Pastrimi dhe gjatesia e koçanit.:Të jene të pastruara dhe me 2-3 gjethe të gjelbera, të lidhura me koçanin i cili të jete deri ne 3cm.

3.Demtime të ndryshme mekanike ,semundje e të çara të lehta .Lejohen deri ne 5% e parties me demtime të lehta mekanike ,të çara lehtesisht e të shperthyera si dhe të demtuara lehtesisht nga bryma .Me semundje nuk lejohen .

4.Pesha e kokrrës :

-Per lakren e hershme ,jo me pak se 1 kg .

-Per lakren me pjekje të mesme e të vona , jo me pak se 1.5 kg.

-Per lakren tip “Drinishti” hibride etj ,jo me pak se 0.8 kg.

Ambalazhami dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet:

Prodhuesi.

Lloji i prodhimit.

Cilesia .

Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

10. BANANE

Kerkohet cilesi e pare , te fresketa , me zhvillim normal , ne tufe , me pjekuri teknike te plote :

•Ngjyra te jete jeshile ne te verdhe, me ere dhe arome te kendeshme .karakteristike e ketij kultivari.

•Madhesia e kokrrës te jete mesatare.

•Demtime mekanike nuk lejohen.

•Njolla te kafeta qe tregojne tejkalimin e pjekurise nuk lejohen.

•Gervishtje te lekures nuk lejohen.

•Zbutje te lekures nuk lejohen.

•Amballazhimi te jete ne kuti kartoni standarte tipike per tregetimin e bananes .

•Malli te jete i shoqeruar me etiketen e cilesise .

11. PORTOKALLE

Bazuar ne STASH 1722\88.

Lloji: Portokalle per treg cilesia e pare.

Kerkesat cilesore : Pamja e jashtme: të fresket, me zhvillim normal ,të shendoshe dhe me bisht .

Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht perkatesisht 5 dhe 20 %.Me pjekuri teknike të plote.

Ngjyra,shija dhe aroma . Ngjyre karakteristike e kultivarit e verdhe ne portokalli me ere karakteristike dhe shije të embel ne të athet, pa shije të hidhur.

Madhesia e kokrrës (diametri me i madh) ne mm jo me pak se 70.

Demtime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen.

Lende të huaja nuk lejohen.

Gervishtje ne siperfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen.

Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të siperfaqes se tyre nuk lejohen.

Të prekura nga oleooza lejohen 2 – 3 njolla per kokerr.

Permbajtja e pesdiciteteve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shendetesise.

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivareve ne arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike

Dokumentat Standarde të Tenderit

ne fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra.

Frutat mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në gryke të cilat të mbushura me fruta, vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohet:

Firma prodhuese.

Lloji i prodhimit.

Cilësia.

Masa neto e bruto.

Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorëve të tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

12. MOLLA

Bazuar në STASH 1752\88.

Lloji: Molle për treg cilësia e parë.

Kërkesat cilësore :

Pamja e jashtme: pjekuria, era dhe shija: të freskëta, me zhvillim normal, të shëndosha e me bisht. Me formë ,ngjyrë e shije të kultivuarit ,pa deformime me 3 pjekuri teknike të njëjtë. Pa erë e shije të huaj.

Madhësia e kokrës (prerë gjerazi, në diametrin me të madh).

Kultivarët me kokërr të zgjatur jo më pak se 70 mm.

Kultivarët me kokërr të rrumbullakët jo më pak se 80 mm.

Kultivarët me kokërr të vogël jo më pak se 60 mm.

Dëmtime mekanike nuk lejohen.

Të prekura nga sëmundjet dhe insektet nuk lejohen.

Të kalbura, të ngrira, njolla nga Monilia (kalbëzimi), lende të huaja nuk lejohen .

Nga krimbi (pa galeri në brendësi).Nuk lejohen.

Nga fuzikladi (kroma e pikalorja).Nuk lejohen.

Të gjitha dëmtimet e sipërme .Nuk lejohen .

Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë .Nuk lejohen .

Gunga (kallo) njolla në lëkurë .Nuk lejohen .

Njolla nga substancat kimike në sipërfaqen e kokrës nuk lejohen.

Përmbytja e pesëditëve të jetë sipas normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të prodhuara sipas standardeve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj frut dhe të pastra.

Frutat mund të ambalazhohen edhe në qeska plasmasi ushqimore ose rrjeta ushqimore të lidhura, të qepura ose të ngjitura në gryke të cilat të mbushura me fruta, vendosen në arka në mënyrë të tillë, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

